



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada - Government**

*Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice*

*Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministra Pravde - Office of Minister of Justice*

Nr. 29 /2025

Datë: 27 / 01 /2025

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2), dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (GZ, Nr.7/01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 50 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në pajtim me Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores QRK-nr.14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, si dhe në bazë të kërkesës së datës 15.01.2025, Ministria e Drejtësisë, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e znj. Afrore (Adem) Zatriqi për korrigjimin e Vendimit dhe Certifikatës së Licencës me të cilën është emëruar për të ushtruar funksionin e noterit në Republikën e Kosovës.

2.Ndryshohet dhe plotësohet pika 1 e Vendimit Nr.246/2024, të datës 15.07.2024 me pjesën integrale të tekstit, si në vijim:

“Znj. Afrore (Adem) Ukaj Zatriqi.”

3.Obligohet Departamenti për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika, për zbatimin e këtij Vendimi dhe që të bëjë korrigjimin e Certifikatës së Licencës nr.29/2024, të datës 30.07.2024.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

## Arsy e tim

Znj. Afrore (Adem) Zatriqi më datë 15.01.2025 ka parashtruar kërkesë në Ministrinë e Drejtësisë për korrighimin e mbiemrit në Vendimin nr. Nr. 246/2024, të datës 15.07.2024, me të cilin është emëruar në detyrën e noterit në juridiksionin territorial të Komunës së Pejës dhe Licencën nr.29/2024, të datës 30.07.2024, pasi që tani ka ndërruar mbiemrin, ku ka prezantuar edhe Vendimin nr.103/2024, të datës 28.03.2024.

Duke vepruar në bazë të kërkesës së palës dhe në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Gjithashtu me rastin e ndryshimit dhe plotësimit të këtij Vendimi, do të bëhet edhe korrighimi i certifikatës së licencës së palës nga Departamenti përkatës i Ministrisë së Drejtësisë.



Vendimi i dërgohet:

- Znj. Afrore Ukaj Zatriqi;
- Sekretares së Përgjithshme;
- Odës së Noterëve të Kosovës;
- Departamenti për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.